



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në mbështetje të nenit 21, shkronja “i”, nenit 40, shkronja “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës, në harmoni me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetqeverisjen e komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2004 merr

V E N D I M

PËR NXJERRJEN E BULETINIT INFORMATIV “PRISHTINA”

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Prishtinës nxjerrë Buletinin informativ “Prishtina” (në vijim: Buletini informativ).

Neni 2

Për përgatitjen dhe realizimin e nxjerrjes së Buletinit informativ obligohet Zyra për informim e Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Këshillin redaktues të Buletinit informativ e përcakton Bordi i drejtorve të Komunës.

Neni 4

Buletini informativ nxirret së paku një herë në muaj dhe shpërndahet falas.

Neni 5

Financimi për nxjerrjen e Buletinit informativ bëhet nga buxheti i Komunës.

Neni 6

Buletini informativ, nuk mund të ketë reklama për qëllime profitabile.

Neni 7

Pas çdo numri të publikuar, shefi i Zyrës për informim obligohet që të informoi me shkrim kryeshefin ekzekutiv për numrin e ekzemplarëve, shpenzimet materiale, shpërndarjen dhe mbarëvajtjen e punëve në përgjithësi.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.039-387 DT.27.02.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri